



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1265 prot.

Fushë-Arrëz, më 05.05.2025

VENDIM

Nr. 16, datë 28.04.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.6, DATË 27.01.2025:
"PËR MIRATIMIN E LISTËS TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË SUBVENCIONIM
QIRAJE NË BASHKINË FUSHË-ARRËZ PËR VITIN 2025"**

Bazuar në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; ligjin nr.22/2018, "Për Strehimin Social; VKM :362 datë 29.05.2019, "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij"; VKM Nr.384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore"; VKM Nr.459 datë 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për strehimin"; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 11, datë 07.01.2025 për "Ngritjen e Komisionit të Strehimit për vitin 2025"; Kërkesës së Kryetarit të Bashkisë nr.1186 prot, datë 28.04.2025 "për shtimin e një pike në rendin e ditës të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 28.04.2025" për një "Ndryshim në Vendimin Nr.6, datë, 27.01.2025" me propozim të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, **Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 28.04.2025**, pas shqyrtimit të propozimeve dhe argumentave të paraqitura,

VENDOSI

"Të miratojë masën e subvencionit të qirasë me vlerë totale 3101400 lekë, për periudhën Janar-Dhjetor 2025, për tu financuar në masën 80% nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në vlerën 2481140 lekë dhe në masën 20% nga Bashkia Fushë-Arrëz në vlerën 620280 lekë".

Bashkëlidhur tabela me listën emërore dhe shumat e subvencionimit.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Diasporës, Migracionit, Çështjeve Sociale, dhe Projekteve, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatimeve.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

12 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Ky Vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike sipas pikës 6, neni 55 të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

Zbardhur, më 05.05.2025.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU



Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al